



Duke u bazuar në Nenin 11, 12.2 (c), dhe nenit 17 (f) të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare, nr. 28, 4 qershor 2008), nenit 15, nenit 34 (paragrafi 2 dhe paragrafi 7) dhe nenit 80 të Ligjit për Mbeturina nr. 04/L-060 (Gazeta Zyrtare, nr.17, 29 qershor 2012) i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 08/L-071 (Gazeta Zyrtare, nr. 29, 1 shtator 2022), si dhe nenit 10 pika 3 të Statutit të Komunës së Klinës, nr.01-110-1232/2010 të miratuar me datën 31.03.2010, me rekomandimet e KPF-së të datës 20.03.202, Kuvendi i Komunës së Klinës në mbledhjen e mbajtur më 31/03/2023, miraton këtë:

V E N D I M

Për

miratimin e Rregullores Komunale për Menaxhimin e Mbeturinave në Komunën e Klinës

1. Miratohet Rregullorja komunale, për menaxhimin e mbeturinave në Komunën e Klinës.
2. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është rregullorja komunale për menaxhimin e mbeturinave në Komunën e Klinës.
3. Pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi, shfuqizohet rregullorja me Nr.prot. 01Nr.06-966/2017 e miratuar me datë: 24.02.2017.
4. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës në bashkëpunim me Drejtorinë për Shërbime Publike dhe Emergjencë e Komunës së Klinës.
5. Vendimi hyn në fuqi pas miratimit nga Kuvendi i Komunës, sipas rregullores (QRK) Nr.06/2021 për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores (QRK) Nr. 10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave dhe pas publikimit në ueb faqen zyrtare të Komunës.
6. Me këtë vendim njoftohen: MAPL, kryetari i komunës, drejtoria për shërbime publike dhe emergjencë, arkivi i komunës dhe zyra për informim.

KUVENDI I KOMUNËS SË KLINË

01Nr. 06-11853 /23
Klinë, me 04.04 /23



Kryesuesi,
Fadil Gashi